



Për :	Te gjitha Autoritetet Kontraktuese	Kopja:	Arkivi i KRPP- së
Nga:	Bordi i KRPP-se		
Lënda:	Njoftim lidhur me zbatimin e Platformës së E-prokurimit nga 01.01.2018		
Datë:	04.01.2018		

Të nderuar,

Ne mbështetje të vendimit të Qeverisë së Kosovës Nr.12/79 datë 15.03.2016 dhe në funksion të funksionalizimit të platformës së prokurimit elektronik nga data 01.09.2016 ka filluar aplikimi i platformës së e-prokurimit për të gjitha autoritetet kontraktuese në nivelin qendrorë, ndërsa nga 01.01.2017 edhe nga autoritete në nivelin lokal. Në këtë proces (platformën elektronike) janë përfshirë të gjitha aktivitetet / procedurat e prokurimit publik me vlera të mëdha dhe të mesme.

Duke filluar nga 01.01.2018 Autoritetet kontraktuese do të përgatisin dhe publikojnë te gjitha Njoftimet në platformën elektronike duke përfshirë te gjitha procedurat e prokurimit dhe për të gjitha vlerat (vlera e vogël, e mesme dhe e madhe), përveç atyre minimale dhe/ose procedurave të cilat nuk mund të zhvillohen përmes platformës.

Nga po kjo datë, KRPP nuk do të publikoj të njëjtat në web faqen zyrtare të KRPP-se (<http://krpp.rks-gov.net>) ashtu siç ka vepruar deri me tani, por publikimet do të bëhen vetëm në platformën elektronike (<https://e-prokurimi.rks-gov.net>).

Ndërsa lidhur me mundësinë e dorëzimit të ofertave/tenderëve, Autoritetet Kontraktuese dhe Operatorët Ekonomik janë të obliguar që të ndjekin detyrimet e përcaktuara me Njoftimin “Kërkesa lidhur me zbatimin e Platformës së e-prokurimit” datë 29.08.2016, ku edhe me tej mbetet **MUNDESIA e dorëzimit të tenderit në kopje elektronike ose fizike**, (por jo në të dy versionet njëherësh).

Kjo do të mbetet në fuqi deri në një njoftim tjetër nga KRPP për të cilin do të njoftoheni me kohe.

Te gjitha sqarimet tjera nga Njoftimi i datës 29.08.2016 mbesin në fuqi.

Për çfarëdo paqartësie palët mund ti drejtohen KRPP-se përmes **Tavolinës ndihmese** (kontaktet do të vendosen në web-faqen e KRPP-se dhe platformën elektronike <http://e-prokurimi.rks-gov.net>).